



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:245698  
Datë: 14.05.2024  
Numri i dokumentit: 05682476

**E.nr.1195/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditores F.K. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Besmir Rrahmani nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria Komunale e Arsimit Ferizaj, për pagesën retroaktive dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 14.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.1195/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditores.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1195/23, të datës 04.08.2023 e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditores, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, për pagesën retroaktive dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:245698, të dt.28.03.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 12.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,775.68 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditores.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.1195/23, më datë 14.05.2023**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**